

FORMAT E KËRKESAVE PËR INFORMIM DHE MËNYRAT E ANKESAVE

➤ Kërkesat për informim:

1. Kërkesat për informim që i drejtohen gjykatës në mbështetje të ligjit nr.119/2014.

Sipas ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”:

- Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 - emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 - adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 - përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 - formatin në të cilin preferohet informacioni;
 - çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
- Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- Ankimi administrativ pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 - ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 - ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
- Kërkesa për informim trajtohet nga ana e Autoritetit Publik sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
- Kur kërkesa është e paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e saj, Autoriteti Publik kontakton menjëherë personin për të bërë sqarimet e nevojshme, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës.

- Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës Autoriteti Publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë Autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.
- Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga Autoriteti Publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut.
- Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë, ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.
- E drejta e informimit kufizohet vetëm sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Formati i kërkesës për informim mund të plotësohet pranë ambienteve të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun ose mund të aksesohet online në faqen zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al **Gjykata e Apelit Shkodër në rubrikën “Njoftime për Publikun”.**

2. Kërkesat që i drejtohen gjykatës për tu pajisur me vendimeve gjyqësore ose/dhe kopje të akteve dosjes gjyqësore.

Sipas ligjeve procedurale civile dhe penale, të gjitha palët pjesmarrëse në gjykim mund të pajisjen nga gjykata në çdo kohë lidhur me vendimet gjyqësore, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve/mbrojtësve të tyre me prokurë.

Formati i kërkesës për pajisje me vendimet gjyqësore ose/dhe kopje të akteve gjyqësore plotësohet pranë ambienteve të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun ose mund të aksesohet online në faqen zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al **Gjykata e Apelit Shkodër në rubrikën “Njoftime për Publikun” .**

3. Kërkesat që i drejtohen gjykatës për tu pajisur me kopje të regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Sipas ligjeve procedurale dhe udhëzimeve për këtë qëllim, të gjitha palët pjesmarrëse në gjykim mund të pajisjen nga gjykata në çdo kohë lidhur me cd audio të seanca gjyqësore të çështjeve të ndryshme gjyqësore, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve/mbrojtësve të tyre me prokurë.

Formati i kërkesës për pajisje të CD AUDIO plotësohet pranë ambienteve të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun ose mund të aksesohet online në faqen zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al **Gjykata e Apelit Shkodër në rubrikën “Njoftime për Publikun”.**

➤ **Mënyrat e ankesave ndaj kërkesave për informim:**

1. Ndaj vendimeve gjyqësore ushtrohen rekurse pranë Gjykatës së Lartë nga palët ndërgjyqëse brenda afateve të parashikuara nga ligjet procedurale civile dhe penal. Rekursat depozitohen pranë kryesekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Apelit Shkodër nëpërmjet shërbimit postar ose personalisht nga palet pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun pranë kësaj gjykate.
2. Ndaj kërkesave për informim ushtrohen ankesat pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Formati i ankesës për informim mund të mund të aksesohet online në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit dhe të Gjykatës së Apelit Shkodër www.gjykata.gov.al **Gjykata e Apelit Shkodër në rubrikën “Njoftime për Publikun”** .